

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"W2M ALBANIA" SH.P.K**

Sot më datë 18.01.2023, u paraqit pala e mëposhtme,

World 2 MEET S.L.U, një shoqëri e themeluar dhe që vepron sipas legjislacionit të Spanjës, me seli në adresë Calle General Riera, 154, 07010 Palma de Mallorca, me kod tatimor B62880992, me përfaqësues Z. Alberto Llompert Soler, qytetar spanjoll, lindur në Mallorca (Spanjë) më 18 Shtator 1971, me banim në Spanjë, me pasaportë spanjolle nr. PAP232636, ky i fundit përfaqësuar nga z. Ervin Bano, qytetar shqiptar, lindur në Vlorë (Shqipëri) më 21.07.1977, me numër identifikimi personal H55627133F, sipas prokures se posacme date 23.12.2022 leshuar para noter Armando Mazaira Pereira, noter ne Ishujt Balneari dhe Vendimit te World 2 MEET S.L.U date 22.12.2022.

e cila ka vendosur të nënshkruajë Aktin e Themelimit të mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë "Shoqëria"), aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij akti, së cilës i bashkëngjitet (më poshtë "Shtojca 1").

Neni 1 - Emërtimi

Emërtimi i Shoqërisë është "W2M ALBANIA" Sh.p.k.

Neni 2 - Selia

Selia e Shoqërisë është në Rruga Abdi Toptani, Torre Drin, kati 2, 1001 Tiranë, Shqipëri.

Neni 3 - Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë do të jetë me një afat të pacaktuar.

Neni 4 – Objekti i shoqërisë

- 4.1 Objekti i Shoqërisë do të jetë agjenci udhëtimeve: organizimi dhe kontraktimi i shërbimeve të udhëtimeve me furnizues të autorizuar duke përfshirë por pa u kufizuar në shërbimet e akomodimit, transportit, aktivitete dhe eskursione për marketingun e saj, ofrimin dhe shpërndarjen si rishitës fundor, me pakice, tek klienti dhe me shumice për agjencitë e udhëtimit dhe tur operatorësh.
- 4.2 Gjithashtu, në përputhje me legjislacionin shqiptar, Shoqëria mund të kryejë çfarëdo veprimtarie në lidhje me pronat e luajtshme dhe të paluajtshme, si edhe çdo aktivitet tregtar, industrial ose ndonjë aktivitet tjetër, që mund të konsiderohet i domosdoshëm, i dobishëm apo ndihmës në lidhje me përmbushjen e objektivave të saj.

Neni 5 – Kapitali themeltar

- 5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 116.000,00 ALL (njëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë leke).
- 5.2. Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 1 (nje) kuote, e nënshkruar, me vlerë nominale 116.000,00 ALL (njëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë leke).

Neni 6 - Kontributet

- 6.1 Kontributi në kapitalin e shoqërisë është ofruar si më poshtë:



- World 2 MEET S.L.U, një shoqëri e themeluar dhe që vepron sipas legjislacionit të Spanjës, me seli në adresë Calle General Riera, 154, 07010 Palma de Mallorca, me kod tatimor B62880992, ka kontribuar me një shumë prej 116.000,00 ALL (njëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë leke), e cila do paguhet në llogarinë bankare të Shoqërisë.

6.2 Sipas kontributeve të mësipërme:

- World 2 MEET S.L.U, zotëron 1 (një) kuotë, që përfaqëson 100% (njëqind për qind) të kapitalit të Shoqërisë.

Neni 7 – Transferimi i kuotave

Kuotat i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

Neni 8 – Administrimi

8.1 Me këtë akt emërohet 1 (një) Administratorë i Shoqërisë personi si më poshtë:

- Z. BARTOLOME PABLO GILI ESTRADA, lindur në Ciutadella De Menorca (Spanjë) më 17 Prill 1971, mbajtës i Pasaportës nr. PAN600350.

8.2 Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm, në përputhje me parashikimet e nenit 95 të ligjit nr. 9901, datë 14 prill 2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" dhe nenit 14 të Statutit.

8.3 Administratorëve u jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer të formalitetet e përmbushjen e detyrimeve të parashikuara për themelimin e Shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë qëllim, Administratorët, mund t'u drejtohen për ndihmë të tretëve ose konsulentëve të cilëve mund të delegojnë në tërësi ose pjesërisht kryerjen e aktivitetit të sipërpërmendur.


8.4 Administratori është gjithashtu i autorizuar të veprojë në emër të Shoqërisë në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Ai është gjithashtu i autorizuar, të firmosi të gjitha aktet dhe të marrë përsipër detyrime në emër të Shoqërisë që rrjedhin prej momentit të regjistrimit të saj si edhe ka të drejtë t'i delegojë kompetencat e tyre personave të tjerë.

Neni 9– Gjuha

9.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe me shtojcë përkthimin në gjuhën angleze.

9.2 Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin e akteve si më lartë, versioni në italisht do të jetë i vetmi version ligjërishit detyrues.

ORTAKU I VETËM
World 2 MEET S.L.U


Z. Ervin Bano
Përfaqësues me prokurë

**STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"W2M ALBANIA" SH.P.K**

**KAPITULLI I
FORMA, EMRI , OBJEKTI, SELIA DHE KOHËZGJATJA E SHOQËRISË**

Neni 1 – Forma

- 1.1 Shoqëria W2M ALBANIA Sh.p.k (në vijim "Shoqëria") është krijuar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, dhe veprimtaria e saj rregullohet me anë të këtij Statuti.
- 1.2 Shoqëria kryen aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 1.3 Statuti është në përputhje me legjislacionin shqiptar, dhe çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në to do të rregullohen nga legjislacioni shqiptar.

Neni 2 – Emri

Emri i Shoqërisë është W2M ALBANIA Sh.p.k.

Neni 3 – Objekti

- 3.1 Objekti i Shoqërisë do të jetë agjenci udhëtimesh: organizimi dhe kontraktimi i shërbimeve të udhëtimit me furnizues të autorizuar duke përfshirë por pa u kufizuar në shërbimet e akomodimit, transportit, aktivitete dhe eskursione për marketingun e saj, ofrimin dhe shpërndarjen si rishitës fundor, me pakice, tek klienti dhe me shumice për agjencitë e udhëtimit dhe tur operatorësh..
- 3.2 Gjithashtu, në përputhje me legjislacionin shqiptar, Shoqëria mund të kryejë çfarëdolloj veprimtari në lidhje me pronat e luajtshme dhe të paluajtshme, si edhe çdo aktivitet tregtar, industrial ose ndonjë aktivitet tjetër, që mund të konsiderohet i domosdoshëm, i dobishëm apo ndihmës në lidhje me përmbushjen e objektivave të saj.

Neni 4 – Selia

- 4.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: Rruga Abdi Toptani, Torre Drin, kati 2, 1001 Tiranë, Shqipëri.
- 4.2 Selia e Shoqërisë mund të transferohet në një adresë tjetër me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
- 4.3 Personat përgjegjës për administrimin e Shoqërisë mund të marrin vendime, me miratimin paraprak të Asamblesë së Përgjithshme, për të krijuar degë dhe/ose zyra përfaqësie brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe/ose jashtë saj.

Neni 5 – Kohëzgjatja

- 5.1 Kohëzgjatja e Shoqërisë është për një periudhë të pacaktuar.
- 5.2 Kohëzgjatja e Shoqërisë mund të priset me një vendim të Asamblesë së Përgjithshme.



KAPITULLI II
KAPITALI, ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT DHE TRANSFERIMI I PJESËVE TË KAPITALIT

Neni 6 – Kapitali

- 6.1 Kapitali i Shoqërisë është 116.000,00 ALL (njëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë leke).
- 6.2 Kapitali i Shoqërisë përbëhet nga 1 (një) kuotë, plotësisht e nënshkruar nga ortaku i vetëm.

Neni 7 – Kontributet dhe pjesët e kapitalit

- 7.1 Kontributi në kapital do të jetë si më poshtë:
- World 2 MEET S.L.U, një shoqëri e themeluar dhe që vepron sipas legjislacionit të Spanjës, me seli në adresë Calle General Riera, 154, 07010 Palma de Mallorca, me kod tatimor B62880992, ka kontribuar me një shumë prej 116.000,00 ALL (njëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë leke), e cila do paguhet në llogarinë bankare të Shoqërisë.
- 7.2 Bazuar në kontributet e mësipërme:
- World 2 MEET S.L.U, zotëron 1 (një) kuotë, që përfaqëson 100% (njëqind përqind) të kapitalit të Shoqërisë.

Neni 8 – Zmadhimi i kapitalit

- 8.1 Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet pa ndonjë kufizim, dhe më shumë se një herë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
- 8.2 Në rastin e zmadhimit të kapitalit, të gjithë ortakët kanë të drejtë të nënshkruajnë për zmadhimin në përpjesëtim me pjesët e tyre të kapitalit. Në rastin kur ndonjë nga ortakët heq dorë nga e drejta e tij, pjesët e tij të kapitalit mund të nënshkruhen nga ortakët e tjerë në përputhje me pjesët e tyre respektive të kapitalit.

Neni 9 - Zvogëlimi i kapitalit

- 9.1 Kapitali i Shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Në çdo rast kapitali i shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.
- 9.2 Ortakët përballojnë zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë në të njëjtën masë me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre.

Neni 10 – Transferimi i kuotave

- 10.1 Kuotat janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.
- 10.2 Ortaku që dëshiron të transferojë kuotat në çdo lloj forme, si me shpërblim ashtu edhe pa shpërblim në kuptimin më të gjerë të fjalës, duke përfshirë këtu edhe dhurimin në favor të personave të tjerë të ndryshëm nga ortakët, duhet më parë t'ia ofrojë ato në parabletje ortakëve të tjerë.
- 10.3 Në një rast të tillë ortaku që dëshiron të transferojë kuotën e tij duhet të njoftojë ortakët e tjerë, me letër rekomande me kthim përgjigje, mbi synimin për shitje, duke përcaktuar çmimin, kushtet, modalitetet, emrin e blerësit dhe afatin e transferimit. E drejta e

parablerjes duhet t'i referohet të gjitha kuotave të ofruar për shitje.

- 10.4 Ortakët do të kenë në dispozicion 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga marrja e letrës rekomande, për t'i komunikuar ortakut që transferon kuotat, synimin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes. Në rast se ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar, prezumohet se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.
- 10.5 Në rast se oferta pranohet nga disa ortakë, kuotat e ofruara nga ortaku që transferon kuotat, do të ndahen nga ortakët pranues, në të njëjtën masë me kuotat që ata zotërojnë, përveç rastit kur ka një marrëveshje të kundërt. Në asnjë rast, pranuesi i ofertës nuk mund të ushtrojë pjesërisht të drejtën e parablerjes.
- 10.6 Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, kuotat mund t'u transferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht.

KAPITULLI III ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME, ADMINISTRATORËT, EKSPERTI KONTABËL I REGJISTRUAR

Neni 11 – Asambleja e Përgjithshme dhe kompetencat e saj

- 11.1 Organi vendimmarrës i Shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme.
- 11.2 Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për vendimet në lidhje me çështjet e mëposhtme: ndryshimet e Statutit, emërimi dhe shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabël dhe likuidatorëve, rritjen dhe zvogëlimin e kapitalit, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe shpërbërjen e Shoqërisë, miratimin e buxhetit dhe çdo çështje tjetër të patashikuar nga ky Statut dhe ligji i zbatueshëm.

Neni 12 – E drejta e pjesëmarrjes dhe e votës

- 12.1 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamblesë të Përgjithshme, të paraqesë mendimin e tij dhe të votojë në proporcion me kuotën që ai zotëron në kapitalin e Shoqërisë.
- 12.2 Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër jo-ortak, i pajisur me prokurë të posaçme me shkrim, me anën e së cilës mund të japë votën e tij.
- 12.3 Ortaku nuk mund të lëshojë prokurë për votim për një pjesë të kuotës që zotëron, në qoftë se voton personalisht për pjesën e mbetur.

Neni 13 – Thirrja, kuorumi dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme

- 13.1 Asambleja e Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e inventarit dhe bilancit, të raportit të Administratorit dhe të ekspertit kontabël (nëse është emëruar).
- 13.2 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret në çdo moment nga një prej Administratorëve si edhe prej një ose disa ortakëve që përfaqësojnë të paktën 5% (pesë përqind) të kapitalit themeltar, sipas ligjit të zbatueshëm. Asambleja duhet të thirret nëpërmjet njoftimit me letër rekomande me kthim përgjigje dhe/ose postës elektronike të certifikuar, që duhet t'u dërgohet ortakëve – në adresën e njoftuar Shoqërisë – dhe ekspertit kontabël (nëse është emëruar), të paktën 7 (shtatë) ditë përpara mbledhjes së Asamblesë. Thirrja duhet të përmbajë informacion mbi çështjet që do të trajtohen në Asamble, vendin, orën dhe datën e thirrjes së parë dhe të dytë.

- 13.3 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret edhe jashtë selisë së Shoqërisë, brenda Republikës së Shqipërisë apo jashtë saj.
- 13.4 Në rast se Asambleja e Përgjithshme nuk mbledhet me thirrjen e parë për mungesën e kuorumit të parashikuar në pikën 13.7 të këtij Statuti, Asambleja e Përgjithshme do të shtyhet për në thirrjen e dytë; Asambleja e Përgjithshme do të mbledhet në të njëjtin vend dhe në të njëjtën mënyrë sikurse ishte planifikuar fillimisht.
- 13.5 Mbledhjet e Asamblesë mund të mbahen edhe nëpërmjet telekonferencës dhe videokonferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe që t'u lejohet të ndjekin diskutimin dhe të marrin pjesë aktivisht; pasi të jenë verifikuar këto kërkesa që duhet të rezultojnë në procesverbalin e mbledhjes, Asambleja e Përgjithshme konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari në të cilin duhet të ndodhet edhe Sekretari i mbledhjes.
- 13.6 Asambleja do të konsiderohet se mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve të njoftimit, në rast se janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të gjithë kapitalin themeltar.
- 13.7 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, për të cilat kërkohet shumica e thjeshtë, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë më shumë se 30% (tridhjetë për qind) të kapitalit të Shoqërisë. Vendimet e Asamblesë që kërkojnë një shumicë specifike, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të paktën 51 % (pesëdhjetë për qind) të kapitalit të Shoqërisë.
- 13.8 Asambleja e Përgjithshme vendos mbi ndryshimin e Statutit. Rritja dhe zvogëlimi i kapitalit, transferimi i kuotave, shpërndarja e fitimit, riorganizimi dhe shkrirja e shoqërisë, me votë të favorshme të $\frac{3}{4}$ (tre të katërtat) e ortakëve të pranishëm që zotërojnë të paktën 51% (pesëdhjetë për qind) të kapitalit të Shoqërisë. Në raste të tjera, Asambleja e Përgjithshme vendos mbi shumicën e votave të ortakëve që zotërojnë më shumë se 30% (tridhjetë për qind) të kapitalit të Shoqërisë.
- 13.9 Asambleja e Përgjithshme drejtohet nga Kryetari i emëruar mes ortakëve ose ndonjë person tjetër. Për pasqyrimin e vendimit Asambleja emëron një Sekretar, që mund të jetë edhe jo-ortak.
- 13.10 Vendimet e Asamblesë duhet të nënshkruhen nga Kryetari dhe nga Sekretari i i Asamblesë.

Neni 14 – Administrimi

- 14.1 Shoqëria administrohet nga të paktën 1 (një) apo më shumë Administratorë, emëruar për një afat deri në 5 (pesë) vjet. Në përfundim të afatit, Administratori mund të riemërohet. Administratori mund të dorëhiqet ose shkarkohet në çdo kohë me vendim të Asamblesë se Përgjithshme.
- 14.2 Administratorët përfaqësojnë ligjërisht Shoqërinë, individualisht ose bashkërisht, sipas kompetencave të dhëna nga Asambleja e Përgjithshme.
- 14.3 Administratori/ët mund të emërojnë përfaqësues/ë "*negotia ad*" për kryerjen e detyrave ose kategorive të detyrave specifike.

Neni 15 – Eksperti kontabël i autorizuar

- 15.1 Në rast se kërkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e Përgjithshme, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabël të Shoqërisë mund t'i besohet një ose disa ekspertëve

kontabël të autorizuar, të cilët emërohen për një 1 (një) viti, me mundësinë për t'u rrimëruar nga Asambleja e Përgjithshme.

- 15.2 Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

KAPITULLI IV VITI FINANCIAR, PASQYRAT FINANCIARE DHE FITIMET

Neni 16 - Viti financiar dhe pasqyrat financiare

- 16.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit.
- 16.2 Bilancet vjetore, pasqyrat financiare, inventari, raportet e Administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.
- 16.3 Miratimi i dokumenteve që lidhen me vitin financiar duhet të bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.

Neni 17 – Fitimet

- 17.1 Përveçse kur bihet dakort ndryshe nga ortakët, fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor, u shpërndahen ortakëve në proporcion me kuotën e zotëruar prej tyre.
- 17.2 Asambleja e shkarkohet mund të vendosë edhe krijimin e rezervave të veçanta ose të jashtëzakonshme për qëllime të posaçme apo edhe shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.

KAPITULLI V SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Neni 18 – Prishja

- 18.1 Shoqëria priset me anë të vendimit të Asamblesë së Përgjithshme..
- 18.2 Shoqëria nuk priset në rast të humbjes së zotësisë për të vepruar, paaftësi ligjore, vdekjes, likuidimit ose falimentimit të ortakut.

Neni 19 – Likuidimi

- 19.1 Në rast prishje, Shoqëria duhet të likuidohet.
- 19.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët hartojnë raportin përfundimtar mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, operacionet e likuidimit dhe kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.
- 19.3 Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja e Përgjithshme do të vendosë mbi bilancin financiar përfundimtar, mbi punën e kryer nga likuidatori dhe mbi përfundimin e procedurës së të likuidimit.
- 19.4 Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kredive të maturuara, likuidatori do t'i shpërndajë ortakëve të ardhurat përfundimtare të likuidimit, në proporcion me kuotën e zotëruar prej tyre.

**TITULLI VI
TË NDRYSHME**

Neni 20 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve


- 20.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij statuti, si edhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve (përveç atyre që nuk kanë lidhje me Shoqërinë) ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore, në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.
- 20.2 Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, zgjidhja e saj do t'i besohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Shqipëri.

Neni 21 – Gjuha

Ky Statut nënshkruhet në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze. Për çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij akti, versioni anglisht do të jetë i vetmi me fuqi ligjore.

* * *

ORTAKU I VETËM
World 2 MEET S.L.U


Z. Ervin Bano
Përfaqësues me prokure

**MEMORANDUM OF INCORPORATION
OF THE LIMITED LIABILITY COMPANY
“W2M ALBANIA” SH.P.K.**

Today, on 18.01.2023, the following party appears:

- **World 2 MEET S.L.U.**, a company incorporated and operating under the laws of Spain, with headquarters at Calle General Riera, 154, 07010 Palma de Mallorca, with tax code B62880992, with representative Mr. Alberto Llompert Soler, Spanish citizen, born in Mallorca (Spain) on September 18, 1971, residing in Spain, with Spanish passport no. PAP232636, the latter represented by Mr. Ervin Bano, Albanian citizen, born in Vlora (Albania) on 21.07.1977, with personal identification number H55627133F, according to the special power of attorney dated 23.12.2022 issued before notary Armando Mazaira Pereira, notary in the Balneari Islands and decision of World 2 MEET S.L.U date 22.12.2022,

which, decide to sign this Memorandum of Incorporation of a Limited Liability Company (hereinafter the “Company”), whose activity will be performed pursuant to the Albanian legislation in force and its Articles of Association, which constitutes an integral part of this Memorandum of Association attached hereto as “Exhibit I”.

Article 1 - Company’s Name

The denomination of the Company is “W2M ALBANIA” Sh.p.k.

Article 2 - Registered Office

The registered office of the Company is in Rruga Abdi Toptani, Torre Drin, kati 2, 1001 Tirana, Albania.

Article 3 - Duration

The duration of the Company is unlimited.

Article 4 – Object of activity

- 4.1 The object of Company’s activity is the travel agency; organizing and contracting travel services with service suppliers including but not limited to accommodation service, transport services, activities and excursion for its marketing, offer and distribution on a retail bases to end customers and on wholesalers and bases to other travel agencies and tour operator.
- 4.2 In addition, in compliance with the Albanian legislation, the Company may carry out any transaction related to the movable or immovable properties, as well as any commercial, industrial or other activity, which may be necessary, useful or auxiliary to the foregoing purposes.

Article 5 – Capital

- 5.1 The capital of the Company is ALL 116.000 (one hundred sixteen thousand Albanian Leke).
- 5.2 The capital of the Company consisting of 1 (one) quota, totally subscribed, with a par value of ALL 116.000 (one hundred sixteen thousand Albanian Leke).

Article 6 – Contributions

- 6.1 The contribute on the capital of the Company is provided as follows:
 - WORLD 2 MEET S.L.U.. a company organized and existing under the laws of Spain, having its registered address at Calle General Riera, 154, 07010 Palma de

Mallorca with the tax number B62880992, has contributed in money in the capital of the Company with an amount of ALL 116.000 (one hundred sixteen thousand Albanian Leke), which will be paid in the bank account of the company.

6.2 Based on the cited contributions:

- WORLD 2 MEET S.L.U. owns 1 (one) quota, representing 100% (hundred per cent) of the Company's capital.

Article 7 – Transfer of Quotas

The Company's quotas may be transferred pursuant to the provisions set forth in the Articles of Association.

Article 8 – Administration

8.1 With the present act is appointed 1 (one) Administrator of the Company who is the following person:

- Mr. BARTOLOME PABLO GILI ESTRADA, born in Ciutadella De Menorca (Spain) on 17 april 1971, with passport n. PAN600350.

8.2 The Administrator shall exercise all the powers concerning ordinary management of the Company, in accordance to the provisions under article 95 of the Law no. 9901 "On Entrepreneurs and Commercial Companies" dated 14.04.2008 and article 14 of the Articles of Association.

8.3 The Administrators are granted all necessary powers to perform all the formalities and procedures required for the incorporation of the Company under the legislation in force. To this purpose, the Administrator may address for assistance to third parties and consultants and may delegate to them some or all of the conduct of such activities.

8.4 The Administrator is also empowered to act on behalf of the new Company for the purpose of its registration with the National Center of Registration. The Administrator is also empowered to sign all documents and to contract on behalf of the Company obligations arising from its registration with the National Registration Centre itself and to delegate its powers to other special prosecutors

Article 9 – Language

9.1 This Memorandum of Incorporation is drafted in 3 (three) copies in Albanian with annexed the English translation.

9.2 For every dispute arising from the application and/or interpretation of this act, the Italian version will be binding and the sole having legal effect.

SOLE QUOTAHOLDER
WORLD 2 MEET S.L.U.

Mr. Ervin Bano
Representative



**ARTICLES OF ASSOCIATION
OF THE LIMITED LIABILITY COMPANY
"W2M ALBANIA" SH.P.K**

TITLE I

COMPANY'S FORM, NAME, OBJECT, REGISTERED OFFICE, DURATION

Article 1 – Form

- 1.1. The Company "W2M ALBANIA" Sh.p.k (hereinafter the "Company") has been established as a limited liability company, and is regulated by the present Articles of Association.
- 1.2. The Company carries out its activity pursuant to the Albanian legislation in force.
- 1.3. The Articles of Association are in compliance with the mandatory Albanian legislation and the matters not expressly provided hereto shall be governed by the Albanian law.

Article 2 – Name

The name of Company is "W2M ALBANIA" Sh.p.k.

Article 3 – Object

- 3.1. The object of Company's activity is the travel agency; organizing and contracting travel services with service suppliers including but not limited to accommodation service, transport services, activities and excursion for its marketing, offer and distribution on a retail bases to end customers and on wholesalers and bases to other travel agencies and tour operator.
- 3.2. In addition, in compliance with the Albanian legislation, the Company may carry out any transaction related to the movable or immovable properties, as well as any commercial, industrial or other activity, which may be necessary, useful or auxiliary to the foregoing purposes.

Article 4 – Registered Office

- 4.1. The registered office of the Company is in Rruga Abdi Toptani, Torre Drin, Kati 2, 1001, Tirane, Albania.
- 4.2. The Company's registered office can be transferred to another address by resolution of the General Meeting.
- 4.3. The person responsible for the management of the Company may decide, by previous approval of the General Meeting, to also establish branches and/or representative offices within the Republic of Albania and/or abroad.

Article 5 – Duration

- 5.1. The duration of the Company is unlimited.
- 5.2. The Company may be terminated by a resolution of the General Meeting.

TITLE II

CAPITAL, INCREASE AND REDUCTION OF CAPITAL AND TRANSFER OF QUOTAS

Article 6 –Capital

- 6.1. The Company's capital is ALL 116.000 (one hundred sixteen thousand Albanian Leke).

- 6.2. The Company's capital consists of 1 (one) quota, fully subscribed by the sole quotaholder.

Article 7 – Contributions and quotas

- 7.1. The contributions in the capital are as follows:
- WORLD 2 MEET S.L.U.. a company organized and existing under the laws of Spain, having its registered address at Calle General Riera, 154, 07010 Palma de Mallorca with the tax number B62880992, has contributed in money in the capital of the Company with an amount of ALL 116.000 (one hundred sixteen thousand Albanian Leke), which will be paid in the bank account of the company.
- 7.2. Based on the above mentioned contributions:
- WORLD 2 MEET S.L.U., owns 1 (one) quota, representing 100% (hundred per cent) of the Company's capital.

Article 8 - Increase of capital

- 8.1 The Company's capital may be increased, without any limit and more than once, by resolution of the General Meeting.
- 8.2 In case of increase of capital, all quotaholders have the right to subscribe the increase in proportion to their quota in the capital. In case any of the quotaholders will not exercise his right, his quota may be subscribed by the other quotaholders in proportion to their respective quota.

Article 9 – Reduction of capital

- 9.1 The Company's capital may be reduced by resolution of the General Meeting. In any case the Company's capital may not be reduced under the limit provided by the law.
- 9.2 The quotaholders afford the reduction of the Company's capital in proportion to their quota in the capital.

Article 10 – Transfer of quotas

- 10.1 The quotas of capital are freely transferred between the quotaholders.
- 10.2 The quotaholder who intends to transfer his quotas in any kind, whether for consideration or free of charge in the broadest sense of the term, also including the donation of the quotas to parties other than quotaholders, must offer them first to the other quotaholders.
- 10.3 In this case, the quotaholder who intends to transfer his quota shall give written notice to the other quotaholders, via registered mail return receipt verified, informing them on his decision to transfer the quota, indicating the price, conditions, terms, name of the buyer and the term of transfer. The right of first refusal shall be, in any case, referred to all offered quotas.
- 10.4 The quotaholders shall have 15 (fifteen) days, from the receipt of the notice, to communicate to the quotaholder who intends to transfer the quotas on their decision whether to exercise or not the right of first refusal. If a quotaholder does not answer within the indicated term, his right of first refusal is considered as waived.
- 10.5 If the offer is accepted by more than one quotaholder, the quotas offered by the quotaholder who intends to transfer the quotas are distributed in proportion to their

respective quotas, unless otherwise agreed between the parties. The quotaholder accepting the offer cannot exercise the right of first refusal partially.

- 10.6 In case the right of first refusal is not exercised, the quotas may be transferred to third parties, entirely or in part.

TITLE III GENERAL MEETING, ADMINISTRATORS, PUBLIC CERTIFIED ACCOUNTANT

Article 11 – General Meeting and its powers

- 11.1 The decision-making body of the Company is the General Meeting.
- 11.2 The General Meeting is responsible for decisions regarding the following matters: amendments to Articles of Association, appointment and removal of administrators, accountants and liquidators, increase and reduction of the capital, profit distribution, reorganization and dissolution of the Company, budget approval and any other matter stipulated by these Articles of Association and applicable law.

Article 12 – Right of Voting and Participation

- 12.1 Every quotaholder is entitled to attend the meetings of the General Meeting, to give his own opinion and to cast its vote in proportion with the quota he owns with the capital of the Company.
- 12.2 Every quotaholder is entitled to appoint a representative, who may be not necessarily a quotaholder, empowered by a special power of attorney, through which it confers the casting vote.
- 12.3 The quotaholder may not delegate the voting right for a part of his quota, if he personally votes for the remaining part of it.

Article 13 – Convening, quorum and resolutions of General Meeting

- 13.1 The General Meeting shall be convened at least once a year, within 6 (six) months from the closing of the financial year, in order to approve the inventory and the balance sheet, the report of the Administrator and the report of the public certified accountant (if appointed).
- 13.2 The General Meeting is called by the Administrator or by one or more quotaholders holding at least 5% (five per cent) of the share capital, pursuant to applicable law. The General Meeting should be called through registered mail or electronic mail with evidence of receipt sent to quotaholders - at the domicile communicated to the Company – and to the public accountant (if appointed), at least 7 (seven) calendar days before the meeting. The notice must contain information on the agenda to be discussed in the General Meeting, venue, time and day of the first and second call.
- 13.3 The General Meeting may be held in a location other than the registered office, within the Republic of Albania or abroad.
- 13.4 In the absence of a quorum as set out by 13.7 of these Article of Association, no business shall be transacted at such meeting, and the General Meeting shall be delayed for the second call; following which such General Meeting shall be reconvened at the same location and in the same manner as the initially scheduled General Meeting.
- 13.5 The General Meeting may be held also via audio or videoconference, provided that all participants are identified by the chairman and they are given the possibility to follow the discussion and actively participate in it; after the verification of these requirements which should be recorded in the minutes of the meeting, the General Meeting shall be

considered as held at the place where both the Chairman and the Secretary of the meeting are present.

- 13.6 The General Meeting shall be deemed duly convened and established notwithstanding the formalities governing the calls are not observed, provided that the entire Company's capital is present.
- 13.7 The resolutions of General Meeting, for which is requested a simple majority, are valid if there are present the shareholders representing more than 30% (thirty percent) of the share capital. The resolutions of the General Meeting requesting a specific majority, are valid if are present the quotaholders representing at least 51% (fifty one percent) of the share capital.
- 13.8 The General Meeting resolves on the change of the Articles of Association. Increase and decrease of share capital, transfer of quotas, distribution of profits, reorganization and dissolving of the company, with the favorable vote of $\frac{3}{4}$ (three fourth) of the present quotaholders holding at least 51% (fifty-one percent) of the share capital. In all other cases, the General Meeting resolves on the majority of votes of the quotaholders holding more than 30% (thirty percent) of the share capital.
- 13.9 The General Meeting is chaired by the Chairman appointed among the quotaholders or any other person. The General Meeting appoints a Secretary in order to record the minutes, who may not necessarily be a quotaholder.
- 13.10 The General Meeting decision shall be signed by both Chairman and Secretary.

Article 14 - The Administrator/s

- 14.1 The Company is administered by one or more Administrators, who shall be appointed for a term of up to 5 (five) years. At the end of office term, the Administrator can be reappointed. The Administrator may resign or be dismissed at any time, by decision of the General Meeting.
- 14.2 The Administrators shall legally represent the Company, individually or jointly, as per the powers conferred by the General Meeting.
- 14.3 The Administrator/s may appoint representative/s "*ad negotia*" for the performance of specific duties or categories of duties.

Article 15- Public Certified Accountant

- 15.1 If requested by law or resolved by the General Meeting, the audit of the financial statements and accounting books of the Company shall be performed by one or more certified public accountants, appointed for a period of 1 (one) year, with the possibility to be re-appointed by the General Meeting.
- 15.2 The certified public accountant/s shall have the responsibilities provided in the applicable law.

TITLE IV FINANCIAL YEAR AND STATEMENTS, PROFITS

Article 16 - Financial year and statements

- 16.1 The financial year commences on January 1st and closes on December 31st of each year.
- 16.2 The annual balance sheet, financial statements, inventory, reports of the administrator and certified public accountant are approved by the General Meeting.

- 16.3 The documents related to the financial year must be approved within 6 (six) months from the end of the financial year.



Article 17- Profits

- 17.1 Unless otherwise agreed by the quotaholders, the profits resulting from the annual balance sheet are distributed to the quotaholders in proportion to their quota.
- 17.2 The General Meeting may decide to create extraordinary or special reserves for specific purposes or to postpone the distribution of the profits – in whole or in part for the successive financial years.

**TITLE V
DISSOLUTION AND LIQUIDATION**

Article 18 - Dissolution

- 18.1 The Company may be dissolved by resolution of the General Meeting.
- 18.2 The Company shall not be dissolved in case of inability to act, legal incapacity, death, liquidation or bankruptcy of the quotaholder.

Article 19 - Liquidation

- 19.1 In case the Company is dissolved, it must be liquidated.
- 19.2 In order to manage this procedure, the General Meeting appoints one or more liquidators, who will draft the final liquidation report on the assets and liabilities of the Company, the liquidation operations as well as the necessary time for the liquidation.
- 19.3 At the end of the liquidation procedure, the General Meeting will resolve on the final balance sheet, the work performed by the liquidator/s and termination of the liquidation process.
- 19.4 Following the payment of the creditors and collection of the outstanding credits, liquidator/s will distribute the remaining assets, resulting from the liquidation, to the quotaholders, in proportion to their quotas.

**TITLE VI
MISCELLANEOUS
Article 20 – Dispute resolution**

- 20.1 All disputes arising from or in any way connected or related to the interpretation and/or execution of these Articles of Association, between the quotaholders (except disputes regarding issues not related to the Company) or between one or more quotaholders and the Company, will be solved in an amicable way and settled directly between the interested parties.
- 20.2 If an amicable settlement of the dispute is not reached, the dispute shall be settled by the District Court of Tirana, Albania.

Article 21 - Language

The Articles of Association are executed in 3 (three) copies in Albanian and English language. For every controversy arising from the execution and/or interpretation of the present instrument, the English version will be binding and the only one having legal effect.

SOLE QUOTAHOLDER
WORLD 2 MEET S.L.U.

Mr. Ervin Bano
Representative

Perquotahorues, Konto ya

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER VALBONA SH. SELIMI



V2023052730032398672

DATE 19/01/2023
NR REP 465

VËRTETIM PËRKTHIMI

Sot, më datë 05/01/2023, para meje Notere VALBONA SH. SELIMI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën NR.3, HOXHA TASIM, NR.292, u paraqit personalisht:

PËRKTHYESE:Gerta Ylli, atësia Suad, amësia Dhurata, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë A. Moisiu 36/2/22; Njësia Administrative Nr. 4; 0000; Tiranë, lindur më 27/06/1975, gjendja civile “beqare”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 036313550 dhe nr. personal H55627133F, e cila më deklaroi se përktheu me përpikmëri dhe saktësi dokumentin bashkangjitur “Akt Themelimi i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar :”W2M ALBANIA ”SH.p.k, e nënshkroi rregullisht përpara meje Noteres.

Në referim të nenit 135, i ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”, në Republikën e Shqipërisë unë Noterja vërtetohet nënshkrimi i përkthyeses.

NOTERE

VALBONA SH. SELIMI



SPECIAL POWER OF ATTORNEY

The represented: **Mr. Alberto Llompert Soler**, Spanish citizen, born in Mallorca (Spain), on September 18, 1971, resident in Spain, bearer of the Spanish passport no. PAP232636, in the quality of the Secretary of the Board of Directors and General Attorney of the company WORLD 2 MEET S.L.U.. a company organized and existing under the laws of Spain, having its registered address at General Riera, 154, 07010 Palma de Mallorca, Spain with the tax number B62880992, based on the decision of the Boards of Directors December 22, 2022 .

The representative: **Mr. Ervin Bano**, Albanian citizen, born in Vlore (Albania) on 21.07.1977 with personal identification number H55627133F;
and /or

Ms. Gerta Ylli, Albanian citizen, born in Tirana (Albania) on 27.06.1975 with personal identification number H70721130E.

Today December 23, 2022, in front of me Public Notary, Mr. Armando Mazaira Pereira, is personally present Mr. Alberto Llompert Soler of legal age, with full capacity to act, who in the capacity as above, do hereby appoint Mr. Ervin Bano and/or Ms. Gerta Ylli, as his true and legal representative, empowering them personally with any all necessary powers in order to carry out all the useful and necessary actions relating to the process of constitution and registration of a limited liability company in Albania as by decision of WORLD 2 MEET S.L.U. dated December 22, 2022 (hereafter "Newco"), including but not limited to, draft, approve and sign the Memorandum of Incorporation and the Articles of Association of the Newco, as well as, take any and all necessary actions and/or procedures and file all required documentation for the purpose of establishment and registration of the Newco with the Albanian National Business Centre.

The Representatives are therefore authorized to draft the Memorandum of Incorporation and the Articles of Association, sign them with any related attachments, determine the name, legal seat, duration, share capital and corporate purpose, sign the entire participation in the share capital, as well as appointing the corporate bodies establishing their powers, approving the operating rules that will regulate the activity of the company, inserting in the deed any other necessary and appropriate actions in order to complete this operation, without any lack or indeterminacy of powers being opposed to them.

The Represented declared that he considers all actions performed by the Representatives as valid and performed by him personally.

The Represented declared that he grants to the Representatives the right, within his powers, to appoint other representatives.

This Power of Attorney shall remain in force until revoked in writing.

I, the Notary Public have read this Power of Attorney in full voice to the represented, which declared it in full compliance with his will and I, the Notary Public, certify its signature in accordance with the law.

THE REPRESENTED



Mr. Alberto Llompert Soler

GJ6335179

1072021



APOSTILLE (Convention de La Haye du 5 octobre 1961)	
1. País: Country / Pays :	ESPAÑA
El presente documento público This public document / Le présent acte public	
2. ha sido firmado por has been signed by a été signé par	Don Armando Jesús Mazaira Pereira
3. quien actúa en calidad de acting in the capacity of agissant en qualité de	Notario
4. y está revestido del sello / timbre de bears the seal / stamp of est revêtu du sceau / timbre de	su Notaría
Certificado Certified / Attesté	
5. en at / à	Palma
6. el día the / le	02/01/2023
7. por by / par	el Decano Accidental del Ilustre Colegio Notarial de las Islas Baleares
8. bajo el número No sous no	N5201/2023/000008
9. Sello / timbre: Seal / stamp: Sceau / timbre:	10. Firma: Signature: Signature :



Miguel Amengual Villalonga

Esta Apostilla certifica únicamente la autenticidad de la firma, la calidad en que el signatario del documento haya actuado y, en su caso, la identidad del sello o timbre del que el documento público esté revestido.

Esta Apostilla no certifica el contenido del documento para el cual se expidió.

[No es válido el uso de esta Apostilla en España]

[Esta Apostilla se puede verificar en la dirección siguiente: <https://eregister.justicia.es/>]

Código de verificación de la Apostilla: NA:XdSj-Fnb1-CkjV-Se6p

This Apostille only certifies the authenticity of the signature and the capacity of the person who has signed the public document, and, where appropriate, the identity of the seal or stamp which the public document bears.

This Apostille does not certify the content of the document for which it was issued.

[This Apostille is not valid for use anywhere within Spain]

[To verify the issuance of this Apostille, see <https://eregister.justicia.es/>]

Verification Code of the Apostille: NA:XdSj-Fnb1-CkjV-Se6p

Cette Apostille atteste uniquement la véracité de la signature, la qualité en laquelle le signataire de l'acte a agi et, le cas échéant, l'identité du sceau ou timbre dont cet acte public est revêtu.

Cette Apostille ne certifie pas le contenu de l'acte pour lequel elle a été émise.

[L'utilisation de cette Apostille n'est pas valable en / au Espagne.]

[Cette Apostille peut être vérifiée à l'adresse suivante <https://eregister.justicia.es/>]

Code de verification de l'Apostille: NA:XdSj-Fnb1-CkjV-Se6p



PROKURË E POSAÇME

I Përfaqësuari:

Z. Alberto Llompert Soler, qytetar spanjoll, lindur në Mallorca (Spanjë) më 18 Shtator 1971, me banim në Spanjë, me pasaportë spanjolle nr. PAP232636, në cilësinë e Sekretarit të Bordit të Drejtorëve dhe Avokat i Përgjithshëm i shoqërisë WORLD 2 MEET S.L.U. shoqëri e rregulluar dhe e krijuar sipas legjislacionit spanjoll, me adresë në General Riera, 154, 07010 Pallma de Mallorca, Spanjë me numër identifikimi tatimor B62880992, në bazë të vendimit të Bordit të Drejtorëve datë 22 Dhjetor 2022.

Përfaqësuesit:

Av. Ervin Bano, qytetar shqiptar, lindur në Vlorë (Shqipëri) më 21.07.1977, me numër identifikimi personal H55627133F ;

dhe/ose

Znj. Gerta Ylli qytetare shqiptare, lindur në Tiranë (Shqipëri) më 27.06.1975, me numër identifikimi personal H70721130E.

Sot më datë 23 Dhjetor 2022, përpara meje Noterit, Z. Armando Mazaira Pereira, u paraqit personalisht Z. Alberto Llompert Soler, në cilësinë si më sipër, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, më deklaroi se emëron si përfaqësues të tij ligjor Av. Ervin Bano dhe/ose Znj. Gerta Ylli me kompetenca për të vepruar në emër dhe për llogari të te Përfaqësuarit për procesin e krijimit dhe regjistrimit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në Shqipëri sipas vendimit të WORLD 2 MEET S.L.U. datë 22 Dhjetor 2022 (këtu e më tutje "Shoqëria e Re"), duke përfshirë por pa u kufizuar në, hartimin, miratimin dhe nënshkrimin e Aktit të Themelimit dhe Statutit të Shoqërisë së Re, si dhe çdo veprim dhe/ose procedurë të nevojshme dhe depozitimin e akteve të kërkuara për qëllimin e krijimit dhe regjistrimit të Shoqërisë së Re pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Përfaqësuesit janë të autorizuar për të hartuar Aktin e Themelimit dhe Statutin, të nënshkruajnë ato dhe çdo shtojcë që ka lidhje me to, të përcaktojnë emrin, selinë ligjore, kohëzgjatjen, kapitalin aksionar dhe qëllimin e shoqërisë, nënshkruajnë të gjithë pjesëmarrjen në kapitalin aksionar, si edhe emërtimin e organit të shoqërisë duke u përcaktuar kompetencat, miratimin e statutit të shoqërisë, duke shtuar në akte çdo veprim të përshtatshëm dhe të nevojshëm me qëllim që të përfundojë këtë operacion, me kompetenca të plota.

I Përfaqësuari më deklaroi gjithashtu se të gjitha veprimet e kryera nga Përfaqësuesi i quan të rregullta dhe të mirëqena njëjloj sikur të ishte vetë i pranishëm.

I Përfaqësuari i jep kompetencat e nevojshme Përfaqësuesve të lartpërmendur, në mënyrë që këta të emërojnë përfaqësues të tjerë, në kuadrin dhe me kufizimet e të drejtave të deleguara nga kjo prokurë.

Kjo Prokurë do të qëndrojë në fuqi deri në revokimin me shkrim.

Pasi e lexoi, e kuptoi përmbajtjen e këtij akti, të cilin e deklaroi në përputhje të plotë me vullnetin e tij, nënshkroi para meje Noteres dhe unë e vërtetoj atë sipas ligjit.

I Përfaqësuari

Z. Alberto Llompert Soler

(firmë)

VËRTETIM – Unë, ARMANDO MAZAIIRA PEREIRA, Noter në Kolegjin e Ishujve Balearik, me vendbanim në Palma de Mallorca, Ishujt Balearik, Spanjë, VËRTETOJ si autentike dhe të ligjshme nënshkrimin e Z. ALBERTO LLOMPART SOLER, me numër identifikimi tatimor NIF 43068777N, të cilin gjykoj se ka zotësi të plotë për të vepruar dhe interes të ligjshëm, i cili nënshkruan në praninë time në dokumentin PROKURË, të hartuar në një faqe, që përmban pullën dhe vulën time noteriale, duke përmbushur kështu kërkesën e formularit në aktin e hartuar përpara meje nga nënshkruesi i përcaktuar më sipër, në datën 27 dhjetor 2022, me numër 4972 të protokollit tim, duke qenë i autorizuar në përputhje me dispozitat e nenit 207 të Rregullores së Noterisë, duke deklaruar nënshkruesi se e njeh përmbajtjen e këtij dokumenti dhe shfaq vullnetin që ky dokument të ketë efekt vetëm në Shqipëri, shtet që kërkon si formë të vetme dokumenti vërtetimin e nënshkrimit dhe deklaroj unë, Noteri, se kuptoj përmbajtjen e tij dhe se nuk është në kundërshtim me Ligjet dhe rendin publik. Vërtetuar në Palma, më 27 dhjetor 2022.



Pulla e Noterit
0276290214

Pulla e legalizimit
A352489570

1072021

GJ6335179

APOSTILLE

(Konventa e Hagës e datës 5 tetor 1961)

1. vendi Spanjë
- Ky dokument zyrtar
2. është firmosur nga Don Armando Jesus Mazaira Pereira
3. i cili vepron në cilësinë e Noterit
4. dhe mban vulën/pullën e Noterit
- Vërtetohet
5. në Palma
6. më 02/01/2023
7. nga Kolegji i Notereve i Ishujve Balearik
8. nr. N5201/2023/000008
9. vula/pulla
10. firma
Miguel Amengual Villalonga

Kjo apostilë vërteton autencitetin e nënshkrimit dhe kompetencat e personit që ka nënshkruar dokumentin publik, dhe ku është e përshtatshme, identitetin e pullës apo vulës që mban dokumentin publik.

Apostila nuk vërteton përmbajtjen e dokumentit për të cilën është lëshuar.

(Kjo Apostilë nuk është e vlefshme për përdorim në Spanjë)

[Për verifikimin e lëshimit të Apostilës, shikoni: <https://eregister.justicia.es/>]

Kodi i verifikimit: _____

Perkthim:
Blanca Mena
Brie

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER VALBONA SH. SELIMI



V2023052730030035965

DATE 18/01/2023
NR REP 438



VËRTETIM PËRKTHIMI

Sot, më datë 18/01/2023, para meje Notere VALBONA SH. SELIMI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën NR.3, HOXHA TASIM, NR.292, u paraqit personalisht:

PËRKTHYES: Blerina Meni, atësia Ligor, amësia Elenica, shtetase Shqiptare, lindur në Fier dhe banues në TIRANË, me adresë Ismail Qemali; Nd. 14; H. 4; Ap. 7; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 04/05/1987, gjendja civile “e martuar”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 038308692 dhe nr. personal I75504081J , e cila më deklaroi se përktheu me përpikmëri dhe saktësi dokumentin bashkangjitur “prokure e posacme”, nga gjuha anglze në gjuhën shqipe dhe e nënshkroi rregullisht përpara meje noteres.

Në referim të nenit 135, i ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”,” në Republikën e Shqipërisë unë Noterja vërtetohet nënshkrimi i përkthyeses.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij veprimi, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTERE

VALBONA SH. SELIMI

